



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMUNA BUSHAT  
KËSHILLI I KOMUNËS

Nr. 13 Prot.

Bushat, më datë 28/03/2010

**VENDIM**

Nr. 13, dt. 28/03/2010

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PËRBËRJEN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË SHOQËRISË "NDËRKOMUNALE BUSHAT"SHA.**

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 " Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " i ndryshuar ,neni 8, pika 1, paragrafi VI/b; të ligjit nr.9901, dt.14.04.2008;në Vendimin e Këshillit të Komunës Bushat nr.47, dt 28.08.2008 "Për krijimin e shoqërisë "NDËRKOMUNALE BUSHAT "SHA, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë "NDËRKOMUNALE BUSHAT"SHA ( Neni 30), në bazë të "Memorandumit të Mirëkuptimit për "Zgjidhjen e problemeve të menaxhimit të shërbimeve të depozitimit të mbeturinave urbane të qarqeve Shkodër e Lezhë në vendshkarkimin e mbeturinave në komunën Bushat (Landfill) " dhe vënien në funksionim të projektit të fazës së I-rë të Landfillit" pika 7,8,10,11: Kryetari i Komunës propozoi ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbiqyres (K.M) të shoqërisë "NDËRKOMUNALE BUSHAT "SHA, ku kanë dhënë dorëheqjen :Robert Kreçi-si Kryetar; Gjovalin Suka -anëtar;Qeuthere Qerreti-anëtare dhe në bazë të Memorandumit, K.M do të përbëhet nga 5 ( pesë) anëtare , komuna Bushat do të përfaqësohet me 2(dy) anëtare , Bashkia Shkodër me 1 (një) anëtar, Bashkia Lezhë me 1 (një) anëtar dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Telekomunikacionit me ( një) anëtar. Gjithashtu ,Këshilli i Komunës shqyrtoi propozimet e ardhura nga Bashkia Lezhë dhe MPPTT për anëtarë në KM , të miratuara nga Asambleja e shoqërisë "NDËRKOMUNALE BUSHAT "SHA, dhe në mbledhjen e tij të datës 28/03/2010

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dorëheqjen e z. Robert Kreçi si kryetar i K.M, zj. Qeuthere Qerreti si anëtare, z.Gjovalin Suka si anëtar.

2. Të miratojë përbërjen prej 5(pesë) anëtarësh të Këshillit Mbiqyres të shoqërisë "NDËRKOMUNALE BUSHAT" SHA, sipas pikës 8 të Memorandumit.
3. Të miratojë propozimin e Kryetarit të komunës (në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë) për përfaqësuesit e rinj të komunës Bushat në Këshillin Mbiqyres , z. Fahri Trushi dhe z.Robert Kreçi.
4. Të miratojë propozimin e MPPTT për zj.Ljutvilda Gugushka anëtare.
5. Të miratojë propozimin e Bashkisë Lezhë për z.Nikolin Prendi anëtar.
6. Të bëhen ndryshimet përkatëse në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë.
7. Ngarkohet kryetari i Komunës për zbatimin e këtij vendimi ,si dhe për të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshme ligjore për reflektimin e gjendjes së re të shoqërisë në dokumentacionin ligjor financiar të saj.
8. Plotësimi i këtij vendimi bëhet pas ardhjes së propozimit për anëtar nga Bashkia Shkodër.
9. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

PËR KËSHILLIN E KOMUNËS

SEKRETARE

KRYETARI

Lindita SKUKA

Aleks LUKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMUNA BUSHAT

Nr. 34 Prot.

Bushat më 23/8 /2010

**VENDIM**

Nr. 34 , datë 23/8 /2010

**PER MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE PERBERJEN E KESHILLIT MBIKQYRES  
TE SHOQERISE “NDERKOMUNALE BUSHAT “ SHA.**

Mbështetur në ligjin nr.8652, dt,31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, i ndryshuar neni8, pika 1, paragrafi VI/b; te ligjit nr.9901, dt.14.4.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ,ne Vendimin e Keshillit te Komunes Bushat nr.47, dt.28.08.2008 “Per krijimin e Shoqerise “NDERKOMUNALE BUSHAT SHA”; ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin Shoqerise “NDERKOMUNALE BUSHAT SHA” (neni 30) ; ne baze te pikave 7,8,10,11 te “Memorandumit te Mirekuptimit per Zgjidhjen e Problemeve te Menaxhimit te Sherbimeve te Depozitimit te Mbeturinave Urbane te Qarqeve Shkoder e Lezhe ne Vendshkarkimin e Mbeturinave ne Komunen Bushat (Lanfill) dhe venien ne funksionim te te projektit te fazes se I-re te Landfillit” Kryetari i Komunes ne cilesine e Kryetarit te Asamblese se Shoqerise i propozoi ndryshime ne perberjen e Keshillit Mbiqyres (K.M) te Shoqerise “NDERKOMUNALE BUSHAT SHA”. Ka dhene doreheqjen z.Robert Kreçi si anetar i K.M , e miratuar nga Asambleja e Shoqerise dhe propozoi qe te emerohet z. Vladimir Bezhani, inxhinier kimist.Pasi degjoi propozimin e bere , Keshilli i komunes Bushat ne mbledhjen e dates 23/8 /2010

**VENDOSI:**

1. Te miratoje doreheqjen e z.Robert Kreçi si anetar i Keshillit Mbiqyres te Shoqerise.
2. Te miratoje propozimin e Kryetarit te Asamblese se Shoqerise per te emeruar z. Vladimir Bezhani inxhinier kimist ,si anetar i Keshillit Mbiqyres te Shoqerise.
3. Te behen ndryshimet perkatese ne Statutin e Shoqerise “NDERKOMUNALE BUSHAT SHA”.
4. Per zbatimin e ketij vendimi , si dhe per te ndermarre te gjithe hapat ligjore per reflektimin e gjendjes se re te Shoqerise ne dokumentacionin ligjor –financiar dhe regjistrimin ne QKR ,ngarkohen Kryetari i Komunes ne cilesine e Kryetarit te Asamblese se Shoqerise dhe Administratori i Shoqerise z.Zija Gerbeti .
5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 (dhjete) dite pas shpalljes.

PER KESHILLIN E KOMUNES  
KRYETARI  
Aleks LUKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I KOMUNES BUSHAT

V E N D I M

Nr. 13/1, datë 26.03 2013

Ne mbeshtetje te ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar; Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Statutit te "Nderkomunale Bushat" sh.a (kapitulli III, seksioni 1, neni13) Keshilli i Komunes Bushat me cilesine e Asamblese se Aksionareve te "Nderkomunale Bushat" sh.a pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, lidhur me perfaqesuesit e organeve te tjera ne Keshillin Mbikqyres, me shumice votash ne mbledhjen e pergjithshme te dates 26/03 2013 :

VENDOSI:

I. Te miratoje rizgjedhjen per nje afat 3- vjeçar per anetaret e Keshillit Mbikqyres si me poshte vijon:

1. Fahri Trushi	30.03.2013- 30.03.2016
2.Nikolin Prendi	30.03.2013 – 30.03.2016
3.Ljutvilda Gugushka	30.03.2013- 30.03.2016
4.Vladimir Bezhani	23.08.2010-30.03.2016

II. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

PER ASAMBLENE E PERGJITHSHME TE AKSIONAREVE

KRYETARI I KËSHILLIT TË KOMUNËS

Aleks LUKAJ



**NDERKOMUNALE BUSHAT sh.a**

**KESHILLI I MBIKQYRJES**

**V E N D I M**

**Nr. 1, date 07.01.2014**

Në mbështetje të Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, dhe Vendimit të Keshillit të Komunes Bushat Nr. 75, date 24.12.2013, Këshilli i Mbikqyrjes i Nderkomunale Bushat sha,

**V E N D O S I:**

1. Të shpreh dakortesine me Vendimin e siperpermendur të Keshillit të Komunes Bushat dhe të shkarkoje nga detyra e Drejtorit të Nderkomunale Bushat sha Z. Zija Gerbeti dhe të emeroje në vend të tij Z.Albert Markolaj.
2. Dorezimi i detyres të behet sipas akteve ligjore në fuqi.

**KESHILLI I MBIKQYRJES**

Ljutvilda GUGUSHKA

Fahri TRUSHI

Nikolin PRENDI

Vladimir BEZHANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

Nr. 49, datë 26.03.2016

Për

Miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat sha"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" (neni 54, germa d), Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; Statutit të Ndërkomunale Bushat sha, neni 13, neni 30 germa c", VKK Nr.13.Prot datë 29.03.2016 "Për miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat" sh.a, pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Aksionarëve, Keshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 26.03.2016, me shumicë të cilësuar votash, pas përfundimit të mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshimin në VKK Nr.13.Prot datë 29.03.2016 "Për miratimin e ndryshimeve në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "Ndërkomunale Bushat" sh.a, ku afati i emërimit të Këshillit Mbikqyrës:
  - Ishte: 5 vete.
  - Bëhet: 3 vete.
2. Të emërojë si Kryetar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha", z.Robert Kreçi, me afat 3 (tre) vjeçar. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
3. Të emërojë si anëtar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha", z.Nikoll Markaj me afat 3 (tre) vjeçar. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
4. Të emërojë si anëtar të Këshillit Mbikqyrës të Ndërkomunale Bushat sha", z. Vladimir Bezhani. Afati fillon me date 06.09.2016 deri me 06.09.2019.
5. Anëtarët e mëparshëm, të cilëve u ka mbaruar afati, hiqen nga Këshilli Mbikqyrës.
6. Të hiqet adresa Bushat, Bushat, Zyrat e Komunës, dhe të vendoset adresa Bushat, Njësia Administrative Bushat, Lagjia Qendër, Zona Kadastrale 1329, Nr pasurisë 552, ndërtesë 3 katëshe, kat 1.
7. Sipas Ligjit nr.115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", në të gjithë vendet ku është shprehur Komuna Bushat do të bëhet Bashkia Vau Dejës.

Adresa: Qyteti Vau-Dejës, Rruga "Qafa e Gurit", Tel & Fax:026120006,Email:bashkiavaudejës@hotmail.com

8. Ndryshohet objekti i veprimtarisë nga Pastrimi dhe gjelberimi në teritorin e Komunes Bushat, Mbledhja, sistemimi dhe riciklimi i mbetjeve urbane të Qarkut të Shkodrës dhe pjesërisht të Qarkut Lezhë, Kryerja e shërbimeve në dobi të komunitetit, shërnime keto që janë për tu kryer nga ana e pushtetit vendor në Administrimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane të Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 e Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore".

10. U shpall sot me datë 26/03/2016.

SEKRETARI  
Gentian NDOJ



KRYETARI  
Martin MARKU

Adresa: Qyteti Vau-Dejës, Rruga "Qafa e Gurit", Tel & Fax:026120006,Email:bashkiavaudejës@hotmail.com

KERKESE

DREJTUAR: Qendres Kombetare te Rregjistrimit

Une z. Albert Markolaj me cilesine e administratorit te shoqeris NDERKOMUNALE BUSHAT SHA me NIPT K87108002A kerkoj qe te behen ndryshimet si me poshte:

1. heqjen e adreses Bushat, Bushat, Zyrat e Komunës.
2. shtimin e adreses Bushat, Njesia Administrative Bushat, Lagjia Qender, Zona Kadastrale 1329, Nr pasurise 552, ndertese 3 kateshe, kat 1

Administratori

Albert Markolaj



Shoqeria tregtare " Nderkomunale Bushat" Sha  
Nipt K87108002A  
Adresa: Bushat, ZK nr.1329/552  
Keshilli Mbieqyres

Bushat me , 24.08.2017

VENDIM  
Nr.3, date 24.08.2017

I KESHILLIT MBIKQYRES  
TE SHOQERISE "NDERKOMUNALE BUSHAT" SHA

Sot me date 24.08.2017, u mblodh Keshilli Mbikqyres i shoqerise "NDERKOMUNALE BUSHAT" Sha, me 100% te pjesemaresve , zotrinjeve: Robert Kreçi kryetar, Nikoll Markaj antar dhe Vladimir Bezhani antar. Keshilli Mbikqyres pasi analizoi gjendjen e shoqerise dhe duke konstatuar se Administratorit te shoqerise I ka mbaruar mandate I qendrimit ne detyre

VENDOSI :

1. Zoti Albert Markolaj; deri tani drejtor I shoqerise, te riemrohet perseri si administrator i saj. Mandati qendrimit ne kete detyre do te jete 3 vjet nga data e emrimit.
2. Depozitimin e ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit, Tirane.

Keshilli Mbikqyres  
i Shoqerise "Nderkomunale Bushat" Sha

Robert Kreçi kryetar

Nikoll Markaj antar

Vladimir Bezhani antar



REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
SHOQËRIA NDËRKOMUNALE BUSHAT SHA  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

SHOQËRIA "NDËRKOMUNALE BUSHAT" SHA

NIPT: K817108002A

ADRESA: BUSHAT, SHKODËR

TEL: +355684020490

nr. prot \_\_\_\_\_

Vau Dejës \_\_\_/\_\_\_/2019

VENDIM

Nr. 141 Datë 16/09 2019

**"Për emërimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha"**

*Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Nenin 167 të Ligjit Nr. 9901 Dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723 Dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Nenin 16 dhe 21 pika 2 e Statutit të Shoqërisë me datë 16.12.2013, me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës në datë 06.09.2019 dhe krijimin e vendit vakant,*

VENDOS:

- 1- Të emërojë Z.Kristi Bajo si Kryetar i Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha;
- 2- Të emërojë Z.Rrok Ndoci si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha;
- 3- Të emërojë Z.Ndoc Baqli si anëtar i Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha;
- 4- Mandati i tre anëtarëve, fillon më datë 16/09 2019 dhe përfundon më datë 16/09 2022;
- 5- Për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e Vendimit në QKB ngarkohet Drejtoria e Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha;
- 6- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

KRYETARI

MARK BABANI





REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
SHOQËRIA NDËRKOMUNALE BUSHAT SHA  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

SHOQËRIA "NDËRKOMUNALE BUSHAT" SHA

NIPT: K817108002A

ADRESA: BUSHAT, SHKODËR

TEL: +355684020490

nr. prot \_\_\_\_\_

Vau Dejës \_\_\_/\_\_\_/2019

VENDIM

Nr. 53 Datë 14/10/2019

**“ Për emërimin në detyrë të Administratorit të Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha”**

*Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Nenin 167 të Ligjit Nr. 9901 Dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723 Dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Nenin 16 pika 2/c e Statutit të Shoqërisë. për arsye të mbetjes vakant të vendit të Administratorit,*

VENDOS:

- 1- Të emërojë **Z. Agron Ceka** në detyrën si Administrator i Shoqërisë Ndërkomunale Bushat sha;
- 2- Mandati i Administratorit, fillon më datë 16.10.2019 dhe përfundon më datë 16.10.2022,
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e Vendimit në QKB ngarkohet Shoqëria Ndërkomunale Bushat sh.a;
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

